33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe te jete lëshuar, ose konsiderohet te jete lëshuar, **një certifikatë e pranimit të përkohshëm**.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit te Kontraktuesit, te jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës se defekteve dhe te cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës se defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinvimet do te filloj nga data kur zëvendësimi ose rinvimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinvimi.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendorur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë pune, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto te Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose

b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë se defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë se defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë se defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektit apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësishit derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe te jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tillë do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36

Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërprenë punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsy të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonesës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajt të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimesinë e përmbushjes së punëve sa më pare që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 “**Force Madhore**” siç përdoret këtu mendohet në çrrëgullimet industriale, çrrëgullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërvshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Ne rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësive të parapara me kontratë,

punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritë nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me konratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirim i Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që

është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiken të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES *KUSHTET E VEÇANTA*

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.		
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.	
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha Shqipe .	
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% i vlerës se kontratës me vlefshmëri prej 150 DITESH	
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsy, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 te KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit te kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impanteve, Materialete dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar (ii) e personave të tjera: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar 	

Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë nga data e pranimit te kërkesës se Menaxherit te projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë <i>sipas planit te menaxhimit te kontrates</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 120 ditë.
Dëmet likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Registri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të caktohet me vendim te posatshëm nga ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Sipas Kushteve të përgjithshme të kontratës(Neni 27.1 Mbajtja e parasë)
Shkaqet përkompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë sipas planit te menaxhimit te kontrates.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 2 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<u>Komisioni për Ndërmjetësim ne kuadër te Ministrisë se Drejtësisë</u>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

e me procedurë gjyqësore		ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin përmënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--------------------------	--	--

së dhe rikonstruktimi i rruges dhe trotuareve ne lagjen Sofalia per rruget Shpetim Robajdhe
Sabit Mushica

SHËNIM

Pjesa C: - Formulari i Dorëzimit të Ofertës – ky formularë duhet të përdoret vetëm nëse tenderi dorëzohet në kopje fizike. Përndryshe, në qoftë se tenderi dorëzohet në mënyrë elektronike, formulari krijohet përmes sistemit.

PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Për: KK PRISHTINA

(në vazhdim të tekstit “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i kontratës: Ndertimi i kanalizimit fekal, atmosferik, ujesjellesit si dhe rikonstruktimi i rruges dhe trotuareve ne lagjen Sofalia per rruget Shpetim Robajdhe Sabit Mushica

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: <616 18 012 511>. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.

2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

3. Çmimi total i tenderit është:

Çmimi i tenderit në shifra: 933 447,35 EURO €
Dhe në fjalë XKUQE, SRE, TDE, KATER, KATER, SHANE, TDE, FER Euro

4. Ky tender është valid për një periudhë prej [120 DITE] nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës 10% i vleres se kontrates.

6. Operatori Ekonomik [NNTPP GASHI ING DHE N.T RAHOVICA COMERCE] kanë këtë nacionalitet: [Shqiptar]

7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet], me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjeter.

[Në rast të konsorciumit]


[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [NNTPP GASHI ING]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjeter. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

si ane rikonstruktimi i rruges dhe trotuareve ne lagjen Sofalia per rruget Shpetim Robajdhe
Sabit Mushica


8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rr Ethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kënë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të finançuara nga BKK

9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

E DORËZUAR NGA


IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISET	NNTPP GASHI ING
ADRESA E PLOTE	NEBIH HODO KUQI – SUHAREKË
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	ENVER GASHI
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	12.07.2018
VULA	

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]


	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1 ^a	N.T. RAHOVICA COMERCE	 FERIZAJ
Etj ... *		

* shtoni/fshini reshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciut: [ENVER GASHI]

Nënshkrimi: []

Vendi dhe data: [12.07.2018]

Vula e Udhëheqësit: []

PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR KANALIZIMIN ATMOSFERIK NË RRUGËN SHPËTİM ROBAJ- LAGJA E SOFALISË						
Gjatësia L=2152.21m+128m						
Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
		1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT				
1	1.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike	m'	2280.21	0.2	456.042
	1.2	Pastrimi i terenit në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit.	m'	2280.21	0.2	456.042
	1.3	Demolimi dhe transporti deri në deponi i asfaltit ,betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e gypit të kolektorit të ujrale Atmosferike (gjersia B=1.25m).	m ²	2240.43	0.3	672.129
	1.4	Demolimi dhe transporti deri në deponi i asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e ujëmbledhsave dhe gypit lidhes (gjersia B=80cmm).	m ²	120	1.5	180
	1.5	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e gypit të kolektorit të ujrale Atmosferike (prerja në njëren anë).	m'	1797.6	0.5	898.8
	1.6	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e ujëmbledhsave dhe gypit lidhes. (prerja në dy anë).	m'	180	1	180
	1.7	Demolimi i gypave egzistues të kanalizimit dhe gypave tjer egzistues dhe transporti deri ne deponi.	m'	1797	0.3	539.1
	1.8	Demolimi i pusetave të ndryshme egzistuese me thellsi nga H=1.5-3.5m dhe largimi deri ne deponi.	copë	12	20	240
	1.9	Demolimi i ujëmbledhsave egzistuese duke perfshir puseten dhe gypat lidhës dhe largimi deri ne deponi.	copë	27	15	405
	1.10	Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në kolektorin shkarkues duke perfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme per një funksionim të plotë.	copë	1	200	200
1	1.11	Gërmimi me dorë , makinë , çekan dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dhei është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihr duhet të menjanohet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 2.7m', kurse gjërësia varet nga profili (\varnothing) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				
	a	gërmimi me makinë 75%	m ³	6360	0.4	2544

b	gërmimi me dorë 20%	m ³	1270	0.5	635
c	gërmimi me çekan 5%	m ³	407	1.5	610.5
1.12	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.	m'	2280	0.5	1140
1.13	Zgjërimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 85 pusetë	m ³	37	2.0	74
1.14	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m ² të sipërafares reale të planifikuar.	m ²	3147.5	0.3	944.25
1.15	Furnizimi, shtrierja dhe mbulimi i gypave me shtresë rëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m ³	1883.1	2.5	4707.75
1.16	Furnizimi, transporti dhe vodosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	2472	0.35	865.2
1.17	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m ² .	m ³	5807.2	3.5	20325.2
1.18	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	17	5	85
TOTAL PUNËT E DHEUT :					36,158.01

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME						
2	2.1	Përpunimi i fundit të pusetës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e plakes nga betoni dhe kinetave) . Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vendosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.	m ³	43.5	30	1305
	2.2	Furnizimi, transporti dhe vodosja e betonimit për puseten e ujmbledhësave me dim: 60*40cm.	copë	76	70	5320
	2.3	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lindhja e gypave me llaq cimentoje. Për secilën puse të është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të tij që montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				0
	2.4	a) unaza në formë të konit	copë	85	55	4675
	2.5	b) me profil konstant	m'	180	50	9000
TOTALI						20,300.00

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
3,0 PUNËT METAL PUNUESE						
3	3.1	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	86.0	140.0	12040
	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusetës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.	copë	777.0	3.0	2331
	3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi i grilave të pusetave për ujëbledhësat (prej gize), për pesha të rënda. Në çmim të llogarohet: betonimi i kurores prej beton armesë C-25/30.	copë	77.0	135.0	10395
TOTALI						24,766.00
4,0 PUNËT E MONTUESE						
4	4.1	Furnizimi, transporti dhe vendosja e të gjitha pozicioneve të nevojshme per realizimin e kyqjeve nga objektet egzistuese në puseten e ndertuar duke perfshirë : germim mbulimin me zhavor dhe gypin Ø250mm (gjatësia e lidhjes nga 5-10m).	copë	35	135	4725
	4.2	Furnizimi, transporti dhe realizimi i lidhjes së ujëmbledhsave me puseten e kolektorit kryesorë duke perfshirë hapjen e vrimes me shpim horizontal, gypin e metalt Ø315mm dhe gypin Ø200mm.	m'	50	20	1000
	4.3	Furnizimi, transporti dhe vendosja e të gjitha pozicioneve të nevojshme per realizimin e kyqjeve nga objektet egzistuese në puseten e ndertuar duke perfshirë hapjen e vrimes me shpim horizontal, gypin e metalt Ø315mm dhe gypin Ø250mm (gjatësia e lidhjes nga 5-10m).	copë	30	100	3000
	4.4	Furnizimi, transporti, hapja e vrimes horizontale dhe vendosja e gypit të metalt Ø350mm per vendosjen e gypave të kolektorit kryesor dhe atyre sekondar (Ø250mm).	m'	40	30	1200
	4.5	Furnizimi, transporti, hapja e vrimes horizontale dhe vendosja e gypit të metalt Ø600mm per vendosjen e gypave të kolektorit kryesor dhe atyre sekondar (Ø-500mm).	m'	25	35	875
	4.6	Furnizimi, transporti, ndertimi i pusetes nga betoni i armuar me hapsir të brendëshme 1.5x1.5m lartësi h=2.0m, trashësi të mureve t=15cm, pllaken horizontale t=20cm duke perfshirë armimin me dy rrjeta të armimit me armatur Ø8/15cm, (Puseta PRA1).	copë	1	450	450

4.7	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë Pagesa bëhet për 1 m ³ të gypit të montuar komplet.					0
a	për kolektorë DN- 200 mm	m ³	200	4.5	900	
b	për kolektorë DN- 500 mm	m ³	920	23	21160	
c	për kolektorë DN- 630 mm	m ³	735	37	27195	
d	për kolektorë DN- 800 mm	m ³	630	58	36540	
				TOTALI	97,045.00	

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR
KANALIZIMIN ATMOSFERIK NË RRUGËN SHPËTIM ROBAJ- LAGJA E SOFALISË**

Gjatësia L=2152.21m

1.0	PUNËT E DHEUT	36,158.01
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	20,300.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	24,766.00
4.0	PUNËT MONTUESE	97,045.00
	Totali:	178,269.01 €

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR
KANALIZIMIN FEKAL NË RRUGËN SHPËTIM ROBAJ- LAGJA E SOFALISË**

Gjatësia L=1748.5m

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EUROS
1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT						
	1.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike	m'	1748.5	0.2	349.7
	1.2	Pastrimi i terenit në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit.	m'	1748.5	0.2	349.7
	1.3	Demolimi , transporti deri ne deponi i asfaltit ,betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e gypit të kolektorit të ujравe Fekale (gjersia B=1.25m).	m ²	2294.9	0.3	688.47
	1.4	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e gypit të kolektorit të ujравe Fekale (prerja në njëren anë).	m'	1835.9	0.5	917.95
	1.5	Demolimi i gypave egzistues të kanalizimit dhe gypave tjer egzistues dhe transporti deri ne deponi.	m'	1220	0.3	366
	1.6	Demolimi i pusetave të ndryshme egzistuese me thellsi nga H=1.5-3.5m dhe largimi deri ne deponi.	copë	20	20	400
	1.7	Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në kolektorin shkarkues duke perfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme per një funksionim të plotë.	copë	1	200	200
1	1.8	Gërmimi me dorë , makinë dhe çekan dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV, V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihir duhet të menjanohet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 2.7m ³ , kurse gjërësia varet nga profili (\varnothing) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				0
	a	gërmimi me makinë 75%	m ³	5013	0.4	2005.2
	b	gërmimi me dorë 20%	m ³	1337	0.5	668.5
	c	gërmimi me çekan 5%	m ³	335	1.5	502.5
	1.9	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.	m'	1748	0.5	874

1.10	Zgjërimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 70 puseta	m ³	35	2.0	70
1.11	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m ² të sipërafares reale të planifikuar.	m ²	2275	0.3	682.5
1.12	Furnizimi, shtrierja dhe mbulimi i gypave me shtresë rrëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m ³	1242.1	2.5	3105.25
1.13	Furnizimi, transporti dhe vodosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m	1750	0.35	612.5
1.14	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m ² .	m ³	4280.9	3.5	14983.15
1.15	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	15	5	75
TOTAL PUNËT E DHEUT :					26,850.42

Nr. render	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME						
	2.1	Përpunimi i fundit të pusetës kontrolluese me C-20/25 (për punimin e pllakes nga betoni dhe kinetave). Trashësia (lartësia) mesatare e fundit është 30cm. Këto funde shërbejnë si bazë për vodosjen e unazave të gatshme montuese nga betoni Ø1000 mm, kurse diamaterin e kanë 1.300 mm.	m ³	36.5	30	1095
2	2.2	Furnizimi dhe ndërtimi i unazave montuese të betonit armuar me shpuarjen e hapsirave për vodosjen e gypave të kanalizimit, llidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilën puse të është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të të cilët montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante:				0
	2.3	a) unaza në formë të konit	copë	71	55	3905
	2.4	b) me profil konstant	m'	157	50	7850
					TOTALI	12,850.00

Nr. render	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
3,0 PUNËT METAL PUNUESE						

	3.1	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	71	140	9940
3	3.2	Shkallët në puseta Furnizimi, transporti dhe ndërtim montimi i shkallëve të hekurta Ø 20 mm në murin e pusetës. Shkallat të vendndërtohen në çdo 30 cm me ngjyrosje kundër korozionit. Logaritja me copë.	copë	663	3	1989
					TOTALI	11,929.00

4.0 PUNËT E MONTUESE						
	4.1	Furnizimi, transporti dhe vodosja e të gjitha pozicioneve të nevojshme per realizimin e kyqjeve nga objektet egzistuese në puseten e ndertuar duke perfshirë : germim mbulimin me zhavor dhe gypin Ø250mm (gjatësia e lidhjes nga 5-10m).	copë	35	135	4725
	4.2	Furnizimi, transporti dhe vodosja e të gjitha pozicioneve të nevojshme per realizimin e kyqjeve nga objektet egzistuese në puseten e ndertuar duke perfshirë hapjen e vrimes me shpim horizontal, gypin e metalt Ø315mm dhe gypin Ø250mm (gjatësia e lidhjes nga 5-10m).	copë	30	100	3000
4	4.3	Furnizimi, transporti, hapja e vrimes horizontale dhe vodosja e gypit të metalt Ø350mm per vodosjen e gypave të kolektorit kryesor dhe atyre sekondar (Ø250mm).	m'	20	30	600
	4.4	Furnizimi, transporti, hapja e vrimes horizontale dhe vodosja e gypit të metalt Ø600mm per vodosjen e gypave të kolektorit kryesor dhe atyre sekondar (Ø-500mm).	m'	25	35	875
	4.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet.				0
	4.6	për kolektorë DN- 315 mm	m'	46	9	414
	4.7	për kolektorë DN- 500 mm	m'	1005	23	23115
	4.8	për kolektorë DN- 630 mm	m'	705	37	26085
					TOTALI	58,814.00

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR
KANALIZIMIN FEKAL NË RRUGËN SHPËTIM ROBAJ- LAGJA E SOFALISË**

Gjatësia L=1748.50m

1.0	PUNËT E DHEUT	26,850.42
2.0	PUNËT E BETONIT DHE BETON-ARME	12,850.00
3.0	PUNËT METAL-PUNUESE	11,929.00
4.0	PUNËT MONTUESE	58,814.00
	Totali:	110,443.42 €

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE PËR
KANALIZIMIN ATMOSFERIK NË RRUGËN: SABIT MUSHICA- LAGJA E SOFALISË**

Gjatësia L=1305.66m

Nr. rendor	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
1.0 PUNËT E DEMOLIMIT DHE DHEUT						
	1.1	Trasimi dhe inçizimi me shenjat gjeodezike	m'	1306	0.2	261.2
	1.2	Pastrimi i terenit në pjesën ku do të zhvillohet traseja e kanalizimit.	m'	1306	0.2	261.2
	1.3	Prerja vijore e asfaltit, betonit dhe materialeve tjera të ngurta per krijimin e hapsires per vendosjen e gypit të kolektorit të ujравe Atmosferike .	m'	50	0.5	25
	1.4	Demolimi i gypave egzistues të kanalizimit dhe gypave tjera egzistues dhe transporti deri ne deponi.	m'	350	0.3	105
	1.5	Demolimi i pusetave të ndryshme egzistuese me thellsi nga H=1.5-3.5m dhe largimi deri ne deponi.	copë	4	20	80
	1.6	Demolimi i ujëmbledhsave egzistuese duke perfshir puseten dhe gypat lidhës dhe largimi deri ne deponi.	copë	4	15	60
	1.7	Realizimi i lidhjes së gypit të projektuar në kolektorin shkarkues duke perfshirë hapjen e vrimes mbylljen dhe të gjitha pozicionet e nevojshme per një funksionim të plotë.	copë	1	200	200-
1	1.8	Gërmimi me dorë , makina , dhe Çekan dhe transporti deri në deponi i dheut , me ngarkim dhe shkarkim në vendin ku e cakton organi mbikqyrës, dheu është i kateg. së III-të IV , V dhe VI-të. Tehet e kanaleve duhet të gërmohën në formë të rregullt dhe të përpunohet fundi i kanalit. Dheu i mihur duhet të menjanohet larg kanalit në largësi min. 1,00 m'. - Gërmimi me makina në thellësinë mesatare të kanalit deri në 2.7m' , kurse gjërësia varet nga profili (\varnothing) i gypit, në çmim duhet llogaritur edhe mbrojtja e kanalit nga shembja				0
	a	gërmimi me makinë 60%	m³	1110	0.4	444
	b	gërmimi me dorë 20%	m³	370	0.5	185
	c	gërmimi me çekan 20%	m³	370	1.5	555
	1.9	Mbrojtja e gropes ndërtimore në tërë gjatësin e kanalit.	m'	1305	0.5	652.5
	1.11	Zgjërimi dhe thellimi në vendet e pusetave. Zgjerimi bëhet për nga 50 cm dhe thellimi për 40 cm, në dy metër gjatësi kol. 41 puseta	m³	17.5	2.0	35
	1.11	Planifikimi i fundit të kanalit pas përfundimit të gërmimit duke dhënë ramjen e saktë sipas projektit. Llogaritja bëhet për 1 m ² të sipërfaqes reale të planifikuar.	m ²	1845.3	0.3	553.59

1.12	Furnizimi, shtrierja dhe mbulimi i gypave me shtresë rrëre dhe zhavori d=0-4mm, sipas detajit ne projekt:	m ³	848.4	2.5	2121
1.13	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shiritit sinjalizues mbi shtresen e zhavorit standart per rrjeta te kanalizimit atmosferik.	m'	1410	0.35	493.5
1.14	Mbushja dhe mbulimi i kanalit me material nga guri gelqeror tampon 0-60mm duke e ngjeshur në shtresa max 20-30 cm me Mv>90Mn/m2.	m ³	3577	3.5	12519.5
1.15	Largimi i ujit nga kanali nëse paraqitet gjatë gropimit të kanalit.	ore	10	5	50
TOTAL PUNËT E DHEUT :					18,601.49

Nr. render	Pozicioni (sipas k. tek)	Lloji i Punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total EURO
2,0 PUNËT E BETON. DHE BET.ARME						
